SHPK- "EURO ABI" VITI



RAPORTI

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR DEPONIN E KARBURANTEVE TË LËNGËTA, NAFTË DHE BENZINË NË GERLICE, KAQANIK

Ferizaj, Tetor-2026

Numri i projektit	1'/2026	Ferizaj Tetor/2026
Investitori :	*SHPK- "EUROABI'' VITI* VV Kadrush Rexhepi	
Emërtimi I objektit :	**RAPORT** **I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR DEPONIN E KARBURANTEVE TË LËNGËTA, NAFTË DHE BENZINË NË GERLICË, KK.KAQANIK**	
Lokacioni :	GERLICE	
Përmbajtja :	Ndikimet në mjedisë ,tokë, ajër,ujë , florë,faunë, biodiversitet, masat e marruna për plotësim të kritereve për qëndrueshmëri mjedisore,permbledhja joteknike e RVNM.	
Kompania :	*SHPK- "EUROABI" VITI*	
Autor i raportit :	Dr.sc.Selim Frangu ing.dipl.i gjeol.	
Bashkpunëtor	Leutrim Frangu master hidrogjeolog	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Zivotne Sredine Prostornog Planiranja I Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planing and Infrastructure

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08L/181 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, Ministri i MMPHI lëshon:

Nr. i licencës: 83/18/23

LICENCË

Selim FRANGU
Inxhinier i diplomuar i Gjeologjisë
Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

Data e vlefshmërisë:
19.10.2023— 18.10.2028
Prishtinë

z. Liburn Aliu
Ministër i MMPHI

Permbajtja

1. Hyrje 6
1.1. Qëllimi i hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis 7
1.2. Të dhënat operatorit 9
1.3. Vendndodhja e projektit dhe përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit 10
1.4. Lloji i aktivitetit: depozitimi, pranimi dhe shpërndarja e karburanteve të lëngëta 14
1.5. Metodologjia e vlerësimit të ndikimeve në mjedis 16
1.5.1. Mbledhja dhe shqyrtimi i dokumentacionit 16
1.5.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit 17
1.5.3. Identifikimi i burimeve të mundshme të ndikimit 17
1.5.4. Vlerësimi i ndikimeve sipas komponentëve mjedisorë 18
2. Baza ligjore për hartimin e raportit 18
3.0 PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT 20
3.1.Pozita gjeografike e lokacionit 21
3.2. Popullata dhe Vendbanimet 22
3.3. Lidhjet e Komunikacionit 23
3.4. Kushtet klimatike 23
3.5. Relievi 24
3.6. Hidrogjeologjia 24
3.8. Ndërtimi gjeologjik i rrethinës se gjerë 26
3.8.1. Rreshpet kristalore të Paleozoikut (Pz) 26
3.8.2. Sedimentet e Jurasikut (J_2) 27
3.8.3. Serpentinitet (J_2-J_3) 27
3.8.4. Sedimentet flishore (K_2^3) 27
3.8.4.1. Reshpet biotit-muskovite (sbm) 27
3.8.4.2. Formacioni i Kretakut të sipërm (K_2) 27
3.8.4.3. Sendimentet e Kuaternarit (Q) 28
3.8.4.4 Sedimentet liqenore (J) 28
3.9. Bimësia dhe vegjetacioni 28
3.10. Bota shtazore – *F*auna 29
3.11. Peizazhi 29
3.12. Dukshmëria 29
3.13. Ajri 29
3.14. Uji 30
3.15 Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike 30
3.16. Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike 30
3.17. Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit 31
4. Përshkrimi i Deponis të Karburanteve 31
4.1. Përshkrimi i pajimeve dhe objekteve ndërtimore 31
4.2. Objekti i administratës, ... 33
4.3. Platoja e kompleksit 33
4.4. Rezervarët e karburantit të naftës 33
4.5. Karakteristikat kryesore të procesit të aktiviteteve ne kompleksin e deponis së karburanteve 37

Funksioni 41

4.6. Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve ne kompleksin e deponis së karburanteve 44
4.7. Komponentët dalëse në procesin e aktiviteteve ne kompleksin e deponis së karburanteve 44
5. Përshkrimi i alternativave të projektit 45
5.1. Alternativa e mos funksionimit te deponise se rezervuareve 45
5.2. Alternativa e lokacionit të zgjedhur 45
5.3. Alternativa teknike e rezervuarëve dhe sistemeve mbrojtëse 47
5.4. Alternativa e menaxhimit të ujërave të ndotura 47
5.5. Alternativa e mbrojtjes nga zjarri dhe aksidentet 48
5.6. Arsyetimi profesional për alternativën e përzgjedhur 48
6. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis 49
6.1. Ndotja e ajrit 49
6.2. Ndotja e ujit 50
6.3. Ndotja e tokës 51
6.4. Zhurma 52
6.5. Ndikimet në florë dhe faunë 53
7. Vlerësimi i Rrezikimit të Mjedisit nga Aksidentet e Mundëshme 53
7.1. Vlerësimi i pasojave të mundshme 54
8. Masat e Mbrojtjes së Mjedisit 55
8.1. Masat mbrojtëse të ujërave 55
8.2. Masat për mbrojtjen e tokës 57
8.3. Masat mbrojtëse në rezervuareve 58
8.4. Masat mbrojtëse në sistemin shpërndarës 58
8.5. Rekomandimet tjera për evitimin e rrezikut 59
8.6 Masat për mbrojtje nga zhurma 60
8.7 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë 60
8.7.1 Rekomandime ekologjike për gjelbërim dhe përmirësimin e peizazhit 61
8.8.Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë 62
8.9.Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore 63
8.10 . Menaxhimi i mbeturinave 63
8.11.Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve 64
9.0 Kostoja e parashikuar e realizimit të depos e karborantit te derivateve te naftes dhe benzines per ''Euro Abi '' Shpk 67

1. Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për deponinë e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë – në Gërlicë, Komuna Kadastrale Kaqanik, zona kadastrale Begracë, në njësinë kadastrale: P-70917003, për ngastrat kadastrale në pronësi të kompanisë **EURO ABI Sh.p.k.**, me numër biznesi **810677338**

Ngastra kadastrale , te evidentuara bazuar ne njoftimin komunal e lëshuar më datë **01.10.2026** me numer te references **06-350/02-25335/26**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

06-350/02-25335/26
Kaçanik, më 01.10.2026

Duke u bazuar në Nenin 26 të Rregullores Nr.01/2021 për Organizmin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Kaçanikut pas kërkesës së Euro Abi sh.p.k me Numër Unik Identifikues 810677338 pas shqyrtimit të lëndës, DUKMM jep këtë:

N J O F T I M

Ngastrat kadastrale 01256-0; 01243-0, 01257-0, 01252-0, 01247-0, 01248-0, 01251-0, 01298-0, 01258-0, 01244-0, 01245-2, 01246-2, 01249-2, 01250-2, 01253-2, 01261-2, 01254-0, 01255-2, 01259-2, 01262-2, 01299-2, 01263-2 Zona Kadastrale Begracë, të gjitha pronë individuale e Euro Abi sh.p.k.sipas certifikatave të pronësisë të dorëzuara në DUKMM.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Kaçanikut, në sipërfaqen e parcelave të lartcekura, është paraparë **Vendbanim.**

Të dhënat e destinimit të paraparë, janë marrë nga Plani Zhvillimor Komunal 01.Nr.06-9849/2010 i miratuar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Kaçanikut me datë: 28.12.2010 – i cili tashmë ka skaduar .

- Në Draft Plani Zhvillimor Komunal i cili është në përfundim e sipër kjo zonë parashihet të jetë zonë industriale. Prandaj për kërkesë e kompanisë "Euro Abi Sh.P.k" me Nr. 06-350/02-25335/26, ne mund të konstatojmë se veprimtaria që pretendon të zhvillojë me kod 4671 (Tregti me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to), është në përputhje me kërkesat e zonës Industriale, nuk paraqet ndonjë pengesë pasi që afër kësaj parcele nuk ka ndonjë objekt banimi të ndërtuar. Për të proceduar më tutje kompania "Euro Abi Sh.P.k" duhet ti drejtohet Ministrisë përkatëse për tu pajisur me Licencat e nevojshme për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Zyrtare e Lartë për Mbrojtje të Mjedisit
Ardijë Shehu

Drejtori i DUKMM-së
Korab Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është hartuar sipas kërkesës së **z. Kadrushi Rexhepi**, pronar i kompanisë **"EURO ABI"**, për të aplikuar për **Pëlqim Mjedisor**, dokument i domosdoshëm për marrjen e lejes për deponinë e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë – në Gërlicë, Komuna Kadastrale Kaqanik.

Në këtë raport do të analizohen ndikimet në mjedis nga të gjitha proceset teknologjike që lidhen me funksionimin e deponisë së karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë – në Gërlicë, duke përfshirë edhe masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të zhvillohet kjo veprimtari dhe në rrethinën e saj.

Duke u bazuar në karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në zonën ku planifikohet ndërtimi i deposë, si dhe në potencialet përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhiniero-teknike të projektit nga ana tjetër, është hartuar ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili përkufizon të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në marrëdhënie me lokalitetin dhe mjedisin përreth.

Duke u nisur nga qëllimi i raportit dhe metodologjia e përdorur për hartimin e tij, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ka për qëllim përkufizimin e ndikimeve potenciale dhe përcaktimin e masave që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Gjatë hartimit të raportit janë marrë për bazë ndikimet e mundshme në mjedis dhe masat për zvogëlimin e tyre, si gjatë fazës së operimit të deponisë së karburanteve të lëngëta në Gërlicë, Komuna e Kaqanikut, ashtu edhe pas përfundimit të projektit.

1.1. Qëllimi i hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Qëllimi i hartimit të **Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis** për deponinë e karburanteve të lëngëta, përkatësisht për rezervuarët e **naftës dhe benzinës**, është identifikimi, analizimi dhe vlerësimi profesional i ndikimeve të mundshme që ky aktivitet mund të shkaktojë në mjedis gjatë fazës së renovimit, instalimit, funksionimit, mirëmbajtjes dhe eventualisht mbylljes së aktivitetit.

Ky raport hartohet me qëllim që para realizimit ose vazhdimit të aktivitetit të bëhet një vlerësim i plotë i gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacion dhe të përcaktohen masat e

nevojshme për parandalimin, zvogëlimin ose eliminimin e ndikimeve negative në ajër, ujë, tokë, shëndetin e njeriut, pronë dhe sigurinë e përgjithshme mjedisore. Përmbajtja e raportit mbështetet në kërkesat e **Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2025**, i cili përcakton strukturën, metodologjinë dhe elementet teknike që duhet të përfshihen në raportin e VNM-së.

Duke qenë se nafta dhe benzina janë produkte hidrokarbure me karakter të ndezshëm dhe me potencial për ndotje në rast të rrjedhjeve, derdhjeve apo avullimit, raporti ka për qëllim të vlerësojë në mënyrë të veçantë rreziqet që lidhen me:

- ndotjen e mundshme të tokës nga rrjedhjet aksidentale të karburanteve;
- ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- emetimin e avujve të benzinës dhe hidrokarbureve në ajër;
- krijimin e mbeturinave të kontaminuara me vajra dhe derivate;
- rrezikun nga zjarri, shpërthimi dhe aksidentet teknologjike;
- ndikimet e mundshme në punëtorë, komunitetin përreth dhe infrastrukturën ekzistuese.

Një qëllim tjetër i rëndësishëm i këtij raporti është përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhet të zbatohen nga operatori për të siguruar funksionim të kontrolluar dhe të sigurt të deponisë. Këto masa përfshijnë vendosjen dhe mirëmbajtjen e rezervuarëve sipas standardeve teknike, sigurimin e mbrojtjes sekondare kundër rrjedhjeve, përdorimin e separatorit të vajrave dhe hidrokarbureve, kontrollin e ujërave atmosferike të ndotura, pajisjen me sistem kundër zjarrit dhe krijimin e procedurave për reagim në raste emergjente.

Raporti gjithashtu synon të ofrojë një bazë të qartë për organet kompetente gjatë shqyrtimit të kërkesës për pëlqim mjedisor. Përmes këtij dokumenti paraqiten të dhënat teknike të projektit, gjendja ekzistuese e mjedisit, ndikimet e mundshme, masat mbrojtëse, programi i monitorimit dhe përgjegjësitë e operatorit gjatë funksionimit të aktivitetit.

Në kuptimin profesional, qëllimi i Raportit të VNM-së është të dëshmojë se aktiviteti i deponimit të naftës dhe benzinës mund të zhvillohet vetëm nëse plotësohen kushtet

teknike, mjedisore dhe të sigurisë, si dhe nëse zbatohen të gjitha masat parandaluese dhe mbrojtëse të përcaktuara në këtë raport. Në këtë mënyrë sigurohet që projekti të jetë i pranueshëm nga aspekti mjedisor dhe të mos paraqesë rrezik të papranueshëm për mjedisin, shëndetin e njerëzve dhe pronën përreth.

1.2. Të dhënat operatorit

Investitor dhe operator i projektit për **deponinë e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë**, është kompania:

SHPK "EUROABI" – Viti

Kompania **SHPK "EUROABI"** është subjekt juridik i regjistruar për zhvillimin e veprimtarive afariste, përfshirë aktivitetet që lidhen me deponimin, furnizimin dhe manipulimin me karburante të lëngëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara nga institucionet kompetente.

Për nevoja të këtij raporti, investitori/operatori paraqitet si bartës i përgjegjësisë për zbatimin e projektit, funksionimin e sigurt të rezervuarëve, mirëmbajtjen e pajisjeve teknike, zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore, menaxhimin e mbeturinave dhe respektimin e kushteve që do të përcaktohen në procedurën e pëlqimit mjedisor.

Të dhënat kryesore të investitorit/operatorit janë paraqitur në tabelën në vijim:

Përshkrimi	**Të dhënat**
Emri i subjektit juridik	SHPK "EUROABI"
Vendi / Komuna	Viti
Lloji i projektit	Deponi e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë
Aktiviteti kryesor	Deponim, pranim, ruajtje dhe shpërndarje e karburanteve
Përfaqësuesi i kompanisë	Kadrush Rexhepi
Statusi juridik	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar – SHPK
Përgjegjësia mjedisore	Zbatimi i masave mbrojtëse, monitorimit dhe menaxhimit mjedisor gjatë operimit

Investitori **SHPK "EUROABI"** merr përsipër që gjatë zhvillimit të aktivitetit të respektojë kërkesat ligjore dhe teknike për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë, mbrojtjen nga zjarri, parandalimin e rrjedhjeve të karburanteve dhe kontrollin e ndikimeve të mundshme në ajër, ujë dhe tokë.

Përfaqësuesi i kompanisë, **Kadrush Rexhepi**, përfaqëson operatorin në procedurat administrative dhe institucionale që lidhen me aplikimin për pëlqim mjedisor, si dhe me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Në kuadër të këtij raporti, operatori konsiderohet përgjegjës për sigurimin e kushteve teknike të rezervuarëve, kontrollin periodik të pajisjeve, funksionimin e separatorit të vajrave dhe hidrokarbureve, menaxhimin e mbeturinave të kontaminuara, si dhe për ndërmarrjen e masave të menjëhershme në rast të ndonjë incidenti apo aksidenti mjedisor.

1.3. Vendndodhja e projektit dhe përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

Projekti për **deponinë e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë**, i investitorit **SHPK "EUROABI" – Viti**, është i planifikuar të realizohet në lokalitetin **Gerlicë**, në kuadër të **Komunës së Kaçanikut**, përkatësisht në zonën kadastrale **Begrac**.

Lokacioni i projektit është i vendosur në një kompleks ngastrash kadastrale, të cilat sipas të dhënave të paraqitura përfshijnë kryesisht toka të klasifikuara si **tokë pyjore – mal, klasa III**, si dhe disa sipërfaqe të evidentuara si **rrugë private**. Sipas tabelës së paraqitur, projekti përfshin gjithsej **22 ngastra**, me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth **12,493 m²**.

Të dhënat kryesore të ngastrave ku është i vendosur projekti janë paraqitur në vijim:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Begracë

25 / 04 / 24

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m²
P-70917003-01256-0	Parcelë / Parcela / Parcel	50
P-70917003-01243-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1937
P-70917003-01257-0	Parcelë / Parcela / Parcel	678
P-70917003-01252-0	Parcelë / Parcela / Parcel	506
P-70917003-01247-0	Parcelë / Parcela / Parcel	830
P-70917003-01248-0	Parcelë / Parcela / Parcel	557
P-70917003-01251-0	Parcelë / Parcela / Parcel	526
P-70917003-01298-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1380
P-70917003-01258-0	Parcelë / Parcela / Parcel	412
P-70917003-01244-0	Parcelë / Parcela / Parcel	1295
P-70917003-01245-2	Parcelë / Parcela / Parcel	985
P-70917003-01246-2	Parcelë / Parcela / Parcel	615
P-70917003-01249-2	Parcelë / Parcela / Parcel	398
P-70917003-01250-2	Parcelë / Parcela / Parcel	177
P-70917003-01253-2	Parcelë / Parcela / Parcel	231
P-70917003-01261-2	Parcelë / Parcela / Parcel	133
P-70917003-01254-2	Parcelë / Parcela / Parcel	12
P-70917003-01255-2	Parcelë / Parcela / Parcel	186
P-70917003-01259-2	Parcelë / Parcela / Parcel	313
P-70917003-01260-2	Parcelë / Parcela / Parcel	83
P-70917003-01262-2	Parcelë / Parcela / Parcel	738
P-70917003-01299-2	Parcelë / Parcela / Parcel	287
P-70917003-01263-2	Parcelë / Parcela / Parcel	247

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Sipërfaqja totale e ngastrave të përfshira në projekt është 12,493 m².

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAÇANIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Begracë



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1227

Punoi/Obradio/Created: Visar Mulaku

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Data/ Data/Date: 16.09.2026

Koha/ Vreme/ Time: 02:29:24



Fig.1. Ngastrat kadastrale ''Euro Abi '' Shpk

Aktiviteti i planifikuar në këtë lokacion ka të bëjë me **deponimin, pranimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e karburanteve të lëngëta**, përkatësisht **naftës dhe benzinës**. Në kuadër të projektit parashihet vendosja dhe funksionimi i rezervuarëve për karburante, sistemeve të mbushjes dhe shkarkimit, tubacioneve përcjellëse, pompave, valvulave, platformave manipuluese, sistemit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura me hidrokarbure, si dhe pajisjeve për mbrojtje nga zjarri dhe aksidentet teknologjike.

Për shkak të natyrës së aktivitetit, lokacioni duhet të organizohet në mënyrë që të sigurohet kontroll i plotë i qarkullimit të autocisternave, manipulim i sigurt me karburante, parandalim i rrjedhjeve aksidentale dhe mbrojtje e tokës, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore. Sipërfaqet ku bëhet shkarkimi dhe mbushja e karburanteve duhet të jenë të betonizuara, të izoluara dhe të pajisura me sistem drenazhimi që i drejton ujërat e ndotura drejt separatorit të vajrave dhe hidrokarbureve.

Në aspektin mjedisor, vendosja e projektit në këtë zonë kërkon vëmendje të veçantë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e ngastrave evidentohen si **tokë pyjore – mal, klasa III**. Për këtë arsye, gjatë realizimit dhe funksionimit të aktivitetit duhet të shmanget dëmtimi i panevojshëm i sipërfaqeve përreth, të kufizohet zona operative vetëm brenda kufijve të projektit dhe të zbatohen masa për mbrojtjen e tokës, vegjetacionit, ujërave dhe peizazhit lokal.

Në përgjithësi, projekti paraqet një aktivitet industrial-shërbyes me karakter të veçantë mjedisor, për shkak të ruajtjes së produkteve hidrokarbure. Me zbatimin e masave teknike, mjedisore dhe të sigurisë, ndikimet e mundshme mund të kontrollohen dhe reduktohen në nivel të pranueshëm.

1.4. Lloji i aktivitetit: depozitimi, pranimi dhe shpërndarja e karburanteve të lëngëta

Aktiviteti i planifikuar nga investitori **SHPK "EUROABI" – Viti**, në lokacionin **Gerlicë – Komuna e Kaçanikut**, ka të bëjë me **depozitimin, pranimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e karburanteve të lëngëta**, përkatësisht **naftës dhe benzinës**.

Ky aktivitet i takon kategorisë së veprimtarive që kanë karakter **industrial-shërbyes dhe mjedisor të ndjeshëm**, për shkak të natyrës së produkteve që trajtohen. Nafta dhe benzina janë hidrokarbure të lëngëta, të cilat në rast të manipulimit jo të rregullt mund të shkaktojnë ndotje të tokës, ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe ajrit. Po ashtu, për shkak të vetive të tyre të ndezshme, sidomos benzina, ato paraqesin rrezik potencial nga zjarri, shpërthimi dhe aksidentet teknologjike.

Aktiviteti do të përfshijë këto procese kryesore:

1.4.1 Pranimi i karburanteve të lëngëta

Karburantet do të pranohen përmes autocisternave të specializuara, të cilat transportojnë naftë dhe benzinë deri në lokacionin e deponisë. Gjatë pranimit bëhet kontrolli i dokumentacionit përcjellës, kontrolli vizual i autocisternës, pozicionimi në platformën e shkarkimit dhe lidhja me sistemin përkatës të tubacioneve dhe valvulave. Ky proces duhet të kryhet vetëm në zona të kontrolluara, të betonizuara dhe të pajisura me sistem për mbledhjen e derdhjeve eventuale.

1.4.2 Shkarkimi i karburanteve në rezervuarë

Pas pranimit, karburantet shkarkohen nga autocisternat në rezervuarët përkatës përmes sistemit të mbyllur të tubacioneve. Shkarkimi duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar, duke përdorur pompa, valvula sigurie, lidhje të qëndrueshme dhe pajisje për parandalimin e rrjedhjeve. Gjatë këtij procesi paraqitet rrezik i mundshëm nga derdhjet aksidentale, avullimi i hidrokarbureve dhe emetimi i avujve të benzinës, prandaj kërkohet kontroll i vazhdueshëm teknik dhe mbikëqyrje nga personeli përgjegjës.

1.4.3 Depozitimi dhe ruajtja e karburanteve

Nafta dhe benzina do të ruhen në rezervuarë të projektuar për këtë qëllim, të cilët duhet të jenë të pajisur me sisteme sigurie, mbrojtje nga rrjedhjet dhe kontroll periodik teknik. Rezervuarët duhet të jenë të vendosur mbi bazament të qëndrueshëm dhe të pajisur me mbrojtje sekondare, në mënyrë që në rast rrjedhjeje të parandalohet përhapja e karburantit në tokë apo në sistemin e ujërave. Për benzinën, për shkak të avullueshmërisë më të lartë, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë kontrollit të avujve dhe ventilimit të sigurt.

1.4.4 Shpërndarja e karburanteve

Karburantet e depozituara do të shpërndahen sipas nevojave operative të operatorit, përmes sistemit të pompimit, tubacioneve dhe pajisjeve përkatëse të matjes dhe kontrollit. Shpërndarja mund të realizohet në autocisterna, mjete furnizuese ose sisteme të tjera të miratuara teknike, varësisht nga organizimi i veprimtarisë së operatorit. Edhe gjatë shpërndarjes kërkohet kujdes i veçantë për të shmangur derdhjet, pikimet, avullimin e panevojshëm dhe ndotjen e sipërfaqeve manipuluese.

Në kuptimin mjedisor, ky aktivitet kërkon zbatim të rreptë të masave parandaluese dhe mbrojtëse. Sipërfaqet ku bëhet pranimi, shkarkimi dhe shpërndarja e karburanteve duhet të jenë të papërshkueshme nga hidrokarburet, të pajisura me pjerrësi teknike për drejtimin e ujërave të ndotura dhe të lidhura me separatorin e vajrave dhe hidrokarbureve. Ujërat atmosferike që bien mbi zonat manipuluese nuk duhet të shkarkohen drejtpërdrejt në mjedis pa trajtim paraprak.

Sipas kërkesave të **Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2025**, në raportin e VNM-së duhet të paraqitet përshkrimi i projektit, teknologjia e punës, proceset operative, materialet që përdoren, ndikimet e mundshme dhe masat për parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis. Për këtë arsye, aktiviteti i deponimit të naftës dhe benzinës trajtohet në këtë raport si aktivitet me potencial ndikimi në ajër, ujë, tokë, siguri dhe shëndet publik.

Në përgjithësi, lloji i aktivitetit përfshin një cikël të plotë operativ: **pranim – shkarkim – depozitim – ruajtje – kontroll teknik – shpërndarje**. Ky cikël duhet të zhvillohet në kushte të kontrolluara teknike dhe mjedisore, me qëllim që të parandalohet ndotja, të zvogëlohet rreziku nga aksidentet dhe të sigurohet funksionim i qëndrueshëm i deponisë së karburanteve.

1.5. Metodologjia e vlerësimit të ndikimeve në mjedis

Metodologjia e përdorur për hartimin e **Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis** për deponinë e karburanteve të lëngëta – **naftë dhe benzinë**, bazohet në analizimin e të dhënave teknike të projektit, gjendjes ekzistuese të lokacionit, karakteristikave mjedisore të zonës dhe identifikimit të ndikimeve të mundshme që mund të paraqiten gjatë fazave të ndryshme të aktivitetit.

Vlerësimi është bërë duke u mbështetur në kërkesat e **Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2025**, sipas të cilit raporti i VNM-së duhet të përmbajë përshkrimin e projektit, përshkrimin e gjendjes ekzistuese të mjedisit, analizën e alternativave, identifikimin e ndikimeve, masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative, programin e monitorimit dhe masat për raste emergjente.

Metodologjia e vlerësimit është zhvilluar në disa hapa kryesorë:

1.5.1. Mbledhja dhe shqyrtimi i dokumentacionit

Në fazën e parë janë shqyrtuar të dhënat bazë të projektit, duke përfshirë të dhënat e investitorit **SHPK "EUROABI" – Viti**, lokacionin e projektit në **Gerlicë, Komuna e Kaçanikut**, të dhënat kadastrale të ngastrave, përdorimin aktual të tokës, si dhe karakterin

e aktivitetit që ka të bëjë me deponimin, pranimin dhe shpërndarjen e karburanteve të lëngëta.

Në këtë kuadër janë marrë parasysh:

- të dhënat e investitorit/operatorit;
- të dhënat kadastrale të lokacionit;
- sipërfaqja dhe përdorimi aktual i ngastrave;
- lloji i aktivitetit të planifikuar;
- llojet e karburanteve që do të ruhen;
- kapaciteti i rezervuarëve, sipas projektit teknik;
- infrastruktura ekzistuese dhe qasja në lokacion;
- kërkesat ligjore dhe mjedisore që lidhen me aktivitetin.

1.5.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit

Në këtë fazë është bërë përshkrimi dhe analiza e kushteve ekzistuese mjedisore në zonën ku planifikohet deponia. Janë trajtuar elementet kryesore të mjedisit, si: ajri, toka, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, relievi, vegjetacioni, përdorimi i tokës, zhurma, infrastruktura dhe receptorët e mundshëm të ndjeshëm.

Duke qenë se lokacioni përfshin ngastra të evidentuara kryesisht si **tokë pyjore – mal, klasa III**, gjatë vlerësimit i është kushtuar rëndësi ndikimit të mundshëm në tokë, vegjetacion, peizazh dhe organizimin e hapësirës operative. Gjithashtu, për shkak të natyrës së karburanteve, vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja eventuale me hidrokarbure.

1.5.3. Identifikimi i burimeve të mundshme të ndikimit

Burimet kryesore të ndikimeve janë identifikuar në bazë të proceseve operative që zhvillohen në deponi. Këto procese përfshijnë pranimin e karburanteve me autocisterna, shkarkimin në rezervuarë, ruajtjen e karburanteve, shpërndarjen, mirëmbajtjen e pajisjeve, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe menaxhimin e mbeturinave të kontaminuara.

Burimet kryesore të ndikimit janë:

Burimi i ndikimit	**Ndikimi i mundshëm**
Shkarkimi i karburanteve nga autocisternat	Rrezik nga derdhjet aksidentale dhe ndotja e sipërfaqes manipuluese
Rezervuarët e naftës dhe benzinës	Rrezik nga rrjedhjet, korrozioni ose defektet teknike
Tubacionet, valvulat dhe pompat	Rrezik nga pikimet, rrjedhjet dhe defektet mekanike
Benzina	Avullim, aroma, rrezik nga zjarri dhe atmosfera shpërthyese
Nafta	Ndotje e tokës dhe ujërave në rast derdhjeje

Burimi i ndikimit	Ndikimi i mundshëm
Ujërat atmosferike nga platformat manipuluese	Mundësi e bartjes së hidrokarbureve në mjedis
Mbeturinat e kontaminuara	Rrezik për tokën dhe ujin nëse nuk menaxhohen si duhet
Qarkullimi i autocisternave	Zhurmë, emetime në ajër dhe rrezik aksidental

1.5.4. Vlerësimi i ndikimeve sipas komponentëve mjedisorë

Ndikimet janë vlerësuar sipas komponentëve kryesorë të mjedisit: **ajër, ujë, tokë, zhurmë, biodiversitet, peizazh, shëndet publik dhe siguri teknike**. Për secilin komponent është analizuar natyra e ndikimit, burimi i ndikimit, kohëzgjatja, intensiteti, shtrirja hapësinore dhe mundësia e parandalimit apo zvogëlimit të tij.

2. Baza ligjore për hartimin e raportit

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për **deponinë e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë**, të investitorit **SHPK "EUROABI" – Viti**, hartohet duke u mbështetur në legjislacionin mjedisor të Republikës së Kosovës, aktet nënligjore përkatëse, standardet teknike për ruajtjen e karburanteve, si dhe kërkesat institucionale për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit të njerëzve dhe sigurisë nga rreziqet teknologjike.

Baza kryesore ligjore për këtë raport është **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, i cili rregullon procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të projekteve të propozuara. Ky ligj ka hyrë në fuqi pas publikimit më 06.01.2023 dhe ka zëvendësuar ligjin e mëparshëm për VNM.

Përmbajtja dhe struktura e këtij raporti harmonizohet me **Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet tjera teknike të raportit**, i cili përcakton elementet që duhet të trajtohen në raportin e VNM-së. Ky udhëzim kërkon që raporti të përfshijë përshkrimin e projektit, analizën e alternativave, gjendjen ekzistuese të mjedisit, ndikimet e mundshme, masat mbrojtëse, programin e monitorimit dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

Aktiviteti i deponimit të karburanteve të lëngëta, për shkak të ruajtjes dhe manipulimit me naftë dhe benzinë, trajtohet si aktivitet me ndjeshmëri të veçantë mjedisore dhe të sigurisë. Për këtë arsye, baza ligjore nuk kufizohet vetëm në ligjin për VNM, por përfshin edhe legjislacionin për mbrojtjen e ajrit, ujërave, tokës, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen nga zjarri, planifikimin hapësinor dhe ndërtimin.

1. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 – parimet e parandalimit, zvogëlimit të ndotjes dhe përgjegjësitë e operatorit.

2. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)**
   – Rregullon procedurat për identifikimin, vlerësimin dhe miratimin e ndikimit në mjedis për projektet që ndikojnë në mjedis, siç janë depot e karburanteve.
3. **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit**
   – Ligj bazë që përcakton parimet e përgjithshme për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë.
4. **Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** *(i mëhershëm, i zëvendësuar pjesërisht nga 08/L-181)*
   – Ka qenë bazë për VNM dhe mbetet referencë për raste të kaluara apo në plotësim të kuadrit aktual.

5. **Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor**
   – Përcakton zonifikimin dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndërtim.
6. **Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtimin**
   – Përcakton kushtet dhe procedurat për marrjen e lejes ndërtimore për objektet teknike si depot e karburanteve.
7. **Ligji Nr. 06/L-024 për Lejet dhe Licencat**
   – Regullon mënyrën e pajisjes me leje për aktivitetet e rregulluara.

8. **Ligji Nr. 04/L-140 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**
   – Për mbrojtjen e punonjësve gjatë operimit të depos.
9. **Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtjen nga Zjarri**
   – Shumë i rëndësishëm për depot e karburanteve që janë me rrezik të lartë.
10. Ligji për Mbeturina nr.08/L-071 per ndryshimindhe plotesimin e ligjit me Nr. 04/L-060

11. Ligji nr. 04/l-147 për Ujërat e Kosovës
12. **Ligji për Zhurmën në Mjedis**
13. Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
14. Ligjit nr.2003/3 per pyjet e Kosoves nr. 03/L-153

Udhëzimet tjera Administrative

15. - Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujorë.

16. **Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2025**
17. Përcakton përmbajtjen, metodologjinë, përputhshmërinë ligjore dhe aspektet teknike të raportit të VNM-së.
18. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2022 për VNM-të
    – Përcakton format, përmbajtjen dhe procedurat e aplikimit për Pëlqim Mjedisor dhe VNM.
19. Udhëzimi Administrativ për Sigurinë Teknike të Rezervuarëve të Naftës dhe Produkteve të saj

20. Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr. 03/2021 per menaxhimin e mbeturinave te rrezikshme.
21. Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr. 08/2017 per menaxhimin e deponive te mbeturinave
22. Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr.07/2021 per rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajer nga burimet e palevizshme te ndotjesb) dokumentacioni teknik
23. Udhëzimi administrativ(ME) Nr. 02/2023 per caktimin e energjise elektrike nga burimet e ripertritshme te energjise.

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos vizitave që iu janë bërë lokalitetit disa herë, konsultimeve që janë bërë me pronarin dhe ekspertët që do te udhëheqin deponin e karburanteve të lëngëta naftë dhe benzinë, gjithashtu janë shfrytëzuar edhe:

- Projekti i ndërtimit të depos së karburanteve me objektet përcjellëse
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Kopja e planit të ngastrave
- Plani i situacionit

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktiva përkatëse si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC)

3.0 PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren .

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.



3.1.Pozita gjeografike e lokacionit

Pjesa e sipërfaqes ku eshte deponia e karburanteve të lëngëta naftë dhe benzinë në Gërlicë gjendët në pjesën jugore të Kosovës, 2.5 kilometra në pjesen jugore të Ferizajit , në anën e djathtë të rrugës kryesore Gerlice-Ferizaj, gjegjësisht mbi 600 m larg prej rrugës së asfaltuar dhe 251m larg nga autostrada. Kufiri me i aferte i ngastres me hekurudhen eshte 29.5m, hekurudh e cila do te sherbej ne furnizim me derivate te naftes dhe benzines. Shtepija me aferte e banimit me rezervuarin me te aferte te derivateve te lengeta eshte 89.22m (Fig.3).



Fig3.Depoja e karboranteve të lengëta në Gërlicë e "EURO ABI" SHPK

Në aspektin morfologjik, regjioni përbëhet nga pjesë me relief të lartë mbi 600 m kurse fabrika eshte e vendosur ne kuoten më 540 m.

Lidhjet me komunikacionin rrugor janë mjaftë të mira, përmes udhëkryqit të magjistrales Ferizaj-Shkup me rrugën Ferizaj-Viti, deponia e rezervuareve të derivateve të naftës dhe

benzines lidhet me rrugën e asfaltuar , Ferizaj - Han i Elezit dhe Ferizaj-Prishtinë, mandej Fushë Pajtimit- Shterpcë-Prizeren dhe me të gjitha pjesët e Kosovës.

Me qenëse kjo pjesë e Kosovës është më tepër kodrinoro-malore dhe shumë pakë me tokë bujqësore vetëm për gjatë ultësirës Ferizaj- Prishtine, këtu popullata më tepër është e punësuar në fabrikën e prodhimit te bllokut Silcapor në Kaqanik si dhe në fabrikën e çimentos në Hanë të Elezit, kurse një pjesë merret me bujqësi dhe blegtori dhe ne bisnese private..



Figura 3. Pozita gjeografike e Deponisë së rezervuareve të naftës dhe benzines -Gerlice e Ulet

3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Komuna e Kaqanikut ka një popullat e që numron rreth 27716 banor (Plani Hapsinor I Kosoves) banorë kurse vetem qyteti i Kaqanikut , zona urbane numron përafërsisht 10000 banorë me një shkallë të shprehur të migracionit, kurse karakteristikat demografike janë

po ato të Kosovës .Në afersinë e drejtë përdrejtë të lokacionit ku eshte fabrika nuk pritet të kenë ndikim negativ në mjedis, objekti i banimit më i afërt gjendet në distancë mbi 100m.

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

Lokacioni ku gjendet deponia e derivateve te naftes dhe benzines ka lidhje të mira me rrugët rajonale, përmes rrugës së asfaltuar prej 900m qe lidhet me rrugën asfaltuar rajonale te kryqezimi Ferizaji-Viti, Ferizaj-Kaqnik dhe Ferizaj Prishtine ne Gerlice te , përmes kësaj rruge lidhet edhe me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës ku behet me leht qasja me deponimin e derivateve te langeta te naftes dhe benzines. Nga kjo mund të përfundojmë se lokacioni ka lidhje të mira komunikacioni , me të cilën rritet vlera nga aspekti ekonomik, me qëllim të plasmanit të derivateve te lengeta te naftes dhe benzines me konsumatoret apo bisneset qe merre me kete veprimtari.

3.4. Kushtet klimatike

Territori ku eshte deponia e derivateve te naftes dhe benzines që njihet si pjesa jugore e Kosovës kryesisht ka klimë kontinentale që karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të ftohtë. Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 9.9°C gjer në 10,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 10,3°C. Temperaturat më të larta në vitet e hulumtuara (1986, 1987,1988) janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ulta kanë qenë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore për vitet e hulumtuara janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej (-1,7)-(-3,4°C). Regjimi i reshjeve ne komunën e Ferizajit ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 574 mm deri ne 755 mm (për vitet e hulumtuara). Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2%. Në lokacionin ku do te bëhet deponimi i derivateve te lengeta naftes dhe benzines më së shumti janë të përfaqësuara erërat perendimore. Me intensitet më të madhe të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë

me intensitet më të vogël. Në komunën e Kaqanikut me 27‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

3.5. Relievi

Reliefi me lartësitë, pjerrtësitë dhe format e tyre ndikojnë ne ndërtimin e elementeve klimatike, ne shfaqjen e rrjetit ujor dhe të biomasës.

Rajoni i gjerë i lokacionit ku eshte deponimi i derivateve te lengeta nafte e benzines e shpk ''Euro Abi '', karakterizohet me një relief kodrinorë –fushorë si pjesë jugore e Kosovës me lartësi mbidetare nga 536.9m rrafshi i Gerlices dhe me kodrat për rreth lartësi mbidetare deri 626 m maja Kreshta.

Në afërsi të deponis se rezervuareve në jug-perendim kemi lumin e Neredimes që graviton deri në hyrje të fshatit Gerlice e pastaj me lumin e Neredimes bashkohen lumi i Pleshines dhe i Gaqkes te cilat derdhen ne lumin e Lepencit e me pastaj derdhen ne lumin Vardar.

Deponia e derivateve te lengeta nafte e bebnzine shtrihet në anen e majt te rrafshit te Gerlices, fushore me lartsi mesatare mbidetare prej 540m Këtu mbizotërojnë sedimentet Kuatrnare materiale shpatore.

3.6. Hidrogjeologjia

Karakteristikat hidrogjeologjike të sedimenteve Kuaternare ku i ndërtojnë këto ngastra dhe jashtë tyre janë të thjeshta. Sedimentet e Pliocenit, ne shtresat e sedimentuara,si dhe anash tyre dhe mbi to një pjesë e ujërave sipërfaqësore drenohet në keto shtresat e sedimentuara të cilat më tutje gravitojn deri në lumin e Neredimes, kurse një pjesë nëpër shtresat e sedimenteve liqenore depërtojnë deri në shtresat jo ujë lëshuese apo edhe në çarjet tektonike ku akumulohen gjegjësisht deri në rreshpe.



Fig.4. Harta hidrogjeologjike e terenit të depos së karburanteve të lëngëta

Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësor dhe ato nën tokësor.

Proceset teknologjike gjatë operimit te deponimimit te karboranteve te lengeta nafte e benzine nuk do të ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore si dhe nëntokësore pasi që investitori duhej të ketë vendin e veçantë për precipitimin e vajrave të makinave punuese dhe hedhjen mbeturinave ..

Në aspektin pedologjik , toka ku ndodhen ngastrat bënë pjesë në tokat e pazhvilluara , me një shtresë të materialit fushor karakteristik për sedimentet te kretakut , material fushor, me ngjyrë të kafët jashtëzakonisht e cekët edhe atë sillet nga 0.10 deri 0.30m.

Kurse jashtë deponisë sidomos për gjatë lumit te Neredimes në jug perëndim ku është e mbuluar nga tokat aluviale, deluviale janë toka me rentabilitet të lartë të kultivimit të kulturave bujqësore.

Harta pedologjike e rajonit të ngushtë, ku gjendet deoja e karboranteve te lengeta është tok aluviale mase humusore, argjila, rera, zhavore dhe deluvione, lagështinë e marrin nga ujërat atmosferik. Ph është bazike sidomos në deponin e karboranteve te lengeta , nga analizat kimike shihet se Ph është 7.5 deri në neutrale sepse nuk kemi materie e

shkëmbinjve acidikë në afërsi të MS Përbërje ma të madhe të tokave kemi me ngjyrë kafe e ma pak ato të smonicës. Tokat me ngjyrë kafe janë biologjikisht mjaft aktive të cilat kryesisht përdoren si toka bujqësore, përdorën për bujqësi. Sedimentet liqenore, toke e kuqerremet ne kafe te cilat jane degraduar me ndertimin e depos se karboranteve te lengeta nafte e benzine dhe jane te betonuara, këto toka do ti rikultivojmë dhe ti kthejmë në toka antropogjenë ne gjendje të mëparshme.



Fig.5. Harta pedalogjike e regjionit të depos se karboranteve të lëngëta

3.8. Ndërtimi gjeologjik i rrethinës se gjerë

3.8.1. Rreshpet kristalore të Paleozoikut (Pz)

Kryesisht janë filitet, mikashistet, gnajset kokërrimë, kuarcitet, zonat e mermerit si dhe seria e rreshpeve biotite dhe klorito-epidote. E tërë seria e rreshpeve kristalore është e kryqëzuar me damar dhe apofiza të kuarcit hidrotermal, i cili është i sjellur gjatë gërryerjes së trahiteve dhe leuciteve.

3.8.2. Sedimentet e Jurasikut (J_2)

Gjenden në formë të zonave të shtrira në drejtimin VP-JL të terrenit. Në këto sedimente bëjnë pjesë: ranorët, mergelet, argjilat, gëlqerorët, brekqiet dhe silicorët. Të gjiths litotipet e përmendura ndërrojnëë në distance të shkurtëra (Figura 3.).

3.8.3. Serpentinitet (J_2-J_3)

Janë gjetur në forma massive të madhësive të ndryshme. Shpesh lajmërohen në formë të zonave të ngushta përgjat linjave, vijave tektonike. Masën ultrabazike kryesishtë e paraqesin serpentinitet harcburgite dhe lerzolite.

3.8.4. Sedimentet flishore (K_2^3)

Zënë një pjesë të madhe të terenit. Në pjesën jugore ka fsh. Begrac flishi formon front sedimentesh me trashësi rrethë 8 km. Në veri këto sedimente janë të mbuluara nga brekqet dhe tufet. Ky flish përbëhët nga: ranorët, argjilat, mergelet dhe konglomertet. Vjetërsia është përcaktuar në bazë të llojeve të vërtetuara të mikrofaunës-globotrumcana (*globotrumcana lapparenti*) etj.

3.8.4.1. Reshpet biotit-muskovite (sbm)

Janë shkëmbinjtë më të shumtë të serisë dhe ndertojnë, në formë të një brezi të zgjatur VVP- JJL, kryesishtë terenin në anën lindore të Lepencit. Këta shkëmbinjë e kanë të shprehur foliacionin me shtrirje VP-JL dhe me rënje nga verilindja gjegjësisht nga jugpërendimi.

Keto rreshpe përbëhën nga kuarci , albiti dhe mikat, si përbërëse kryesor. Përveç biotitit, nga mineralet e mikave, në masë të madhe paraqiten edhe muskoviti e sericiti.

Në këta shkëmbinjë vërehen breza të ngushtë filitike dhe koncentrimet minerale, në formë syzore, të përbëra nga kuarci. Sipas të gjitha gjasave, këta shkëmbinj paraqesin millonite të rikristilizuara dhe të migmatizuara (Figura 3.).

3.8.4.2. Formacioni i Kretakut të sipërm (K_2)

Ndërton pjesët e terrenit në lindje të shkëmbinjve metamorfik. Sedimentete Kretakut të sipërm shtrihen në mënyrë trangresive mbi shkëmbinjtë metamforik. Janë të përfaqësuar nga brekçiet heterogjene, të cilat ndërthuren mes vedi me konglomeratet bazale dhe ranorët kokërrtrash, e duke shkuar lartë kalojnë në sedimentet e flishit të kretakut të sipërm, i cili

në lindje të këtij regjioni ka përhapje realativisht të madhe. Vendburimi i cili do të hulumtohet i takon këtij formacioni gjeologjik (Figura 3.).

3.8.4.3. Sendimentet e Kuaternarit (Q)

Ndërtohen nga aluvionet (al) dhe shtrihen në luginat dhe në brigjet e lumit Lepenc, dhe përgjat lumit Nerdime. Këto sendimente përfaqësohën kryesishtë nga depozitimet ranore-lymore, argjiloro-ranore, ranore- zhavorre, zhavorre-koluvione (Figura 3.).

3.8.4.4 Sedimentet liqenore (J)

Shtrihen për gjatë luginës së lumit Neredime në pjesët anësore të tije dhe vazhdojnë në pjesën lindore për gjatë lumit të Moravës së Binqës. Përfaqësohen kryesisht nga zhavori rëra, argjila, gëlqerorët etj (Figura 3.).



Figura 6. Harta gjeologjike e zones se depos se karboranteve të lëngëta

3.9. Bimësia dhe vegjetacioni

Pjesët e ngastrave ku eshte depoja e rezervuareve të naftës dhe benzines janë të betonuara , ne bazë të shqyrtimeve vizuale ne afërsi të zonës ku eshte depoja e karboranteve kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, manaferra, shkurre, etj. Këto bimë u përshtaten kushteve të jetës së tyre në ssedimentet liqenore. Lokacioni përbëhet nga tereni shpator i bute, me vegjetacion të ulët.

Ngastrat ku eshte depoja e karburanteve nuk përmbajnë vlera ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por as edhe si zone me vlera kullosore.

Nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor potencial të futet nën mbrojtje.

Por kjo zonë për shkak të pozitës gjeografik depoja e karboranteve dhe afersise me hekurudhen dhe stacionin hekurudhor është shëndrruar ne zonë industriale, për operime dhe duke perdorur depo e karborantit te derivateve te lengeta ku është duke operuar shpk,,Euro Abi " .

3.10. Bota shtazore – *Fauna*

Zona e ngushtë mund të quhet si zonë jo e përshtatshme për zhvillimin e specieve të ndryshme të faunës sepse është zona në aferësi të vendbanimeve. Bazuar ne florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe ne bazë të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë edhe gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, iriqi etj. Prej brejtësve jetojnë- mijtë , prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm , bolla , breshkat e tokës zhapini i gjelbër , insektet krahëfortë , krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat , bilbilat , thëllënëza e fushës , sorrat , shqiponja , lakuriqi, etj.

3.11. Peizazhi

Peizazhi është i tipit te rrafshit më kodrina të ulëta të cilat shtrihen në pjesen jashte ngastrave. Gjerësia e kësaj kodrine është e ndryshme për gjatë prrockes. Peizazhi është i dëmtuar me ndertim pa kriter dhe në mënyrë jo profesionalë të depos se karborantit te langet te naftes dhe benzines. Në disa pjesë të këtij regjioni po edhe në vetë depon e karboranteve . Në përgjithësi peizazhi është i bukur dhe tërheqës.

3.12. Dukshmëria

Shikuar nga pozita e lokacionit te fabrikes dhe relievit, dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha anët e horizontit. Ne pjesën jug-perëndimore dhe ajo jug-lindore ka një dukshmëri ma te madhe për gjate rrafshit te Gerlice . Vendet që shtrihen ne këtë lokalitet karakterizohen më mjegulla dhe më lagështi të madhe të ajrit gjatë stinës së dimrit.

Edhe kjo zonë nuk përjashton nga ky fenomen por në masë më të vogël, sepse nuk ka kurrfarë uzine e as diçka tjetër që e rritë ndotjen e ajrit dhe për rrjedhojë e zvogëlon dukshmërinë.

3.13. Ajri

Vegjetacioni i mirë, prania e madhe e llojeve të ndryshme të faunës janë treguesit kryesor për pastërtinë e ajrit.

Kjo është zonë kryesisht bujqësore, në afërsi nuk ka ndonjë uzinë ose aktivitet tjetër prodhues që do të ndikonte në ndotjen e ajrit.
Mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të mirë

3.14. Uji

Ne këto pjesë të ngastrave kadastrale dhe ne rrethinën më të gjere të ngastrave ku është e vendosur depoja e karburantit te lenget nafte dhe benzine nuk kemi ujëra sipërfaqësore, ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike.
Ne rrethinën më të gjere të ngastrave kualiteti i ujit është i nivelit të mirë, gjithashtu ne fshatin Gerlice kemi puset e hapura te cilat kane cilësi te mire dhe janë te pijshëm , të cilët shfrytëzohen nga fshataret e këtyre lokaliteteve.
Uji industrial i cili do te shfrytëzohet për ftohje te rezervuareve gjithashtu rrjedh ne pjesë veri-perendimore e cila duhet kalon neper puseta dhe derdhet. Gjithashtu edhe ujrat atmosferike orientohen ne drejtim te pusetave.

3.15 Objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Në zonën ku zhvillohet operimi i pikës së rezervuareve me derivate të naftës, benzinës dhe ,nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike brenda parcelave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre.

3.16. Të dhënat për popullsinë dhe karakteristikat demografike

Në Komunën e Kaçanikut jetonin 33,409 banorë sipas regjistrimit 2015 me 99.8% të tyre të përkatësisë kombëtare shqiptare. Në vitin 1948 Kaçaniku kishte 12,836 banorë. Sipas vlerësimeve ku është marrë parasysh shtimi natyror dhe migrimi, në Komunën e Kaçanikut në vitin 2021 jetonin 34.667 banorë6 , që duke krahasuar me numrin aktual të banorëve në Kosovë 1,773,971, përbëjnë rreth 2% të banorëve të Kosovës. Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se janë edhe rreth 5.184 persona nga Kaçaniku të cilët jetojnë jashtë vendit. Dendësia e popullsisë është 1591 banorë për km², që është pothuaj se e njëjtë me nivelin e Kosovës - 163.22 banorë për km². Qyteti i Kaçanikut me zonën urbane dhe zonat periferike urbane që përfshijnë edhe pjesë të disa zonave kadastrale përreth ka sipërfaqe prej 15.63km² dhe rreth 15,000 banorë. Kjo e fut Kaçanikun në listën e 12 qyteteve më të

mëdha në Kosovë. Fshatrat Begracë, Doganaj, Kaçanik i Vjetër dhe Dubravë listohen si vendbanime rurale të mëdha sa i përket numrit të banorëve, ndërsa fshatrat tjera janë më të vogla. Në Komunë janë gjithsej 5547 ekonomi familjare, ku dominojnë familjet me nga 5 dhe 6 anëtarë si dhe ato me nga 4 dhe 7 anëtarë. Gjithashtu kemi edhe numër të konsiderueshëm që ka 8 e më shumë anëtarë, ndërsa familjet me 1,2 dhe 3 anëtarë janë me numër më të vogël rreth 7.6% e të gjitha familjeve

3.17. Në Zonat me vlera të veçanta shkencore, arkeologjike dhe mjedisore në hapësirën e projektit

Bazuar në dokumentacionin planifikues në fuqi, gjendjen ekzistuese në terren dhe të dhënat në dispozicion për zonën e Gerlices, Komuna e Kaqanikut , në hapësirën ku do te zhvillohet do te operimi me derivate të naftës, benzinës , nuk janë identifikuar zona me vlera të veçanta , vende arkeologjike të regjistruara, apo zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore brenda parcelës së projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të saj.

Në kufijtë e Raporti i Vlerësimit të ndikimit në Mjedis "Euro Abi "Shpk lokacionit ku do te operoj ,nuk evidentohet prania e rezervateve natyrore ose zonave të mbrojtura me status ligjor, zonave të mbrojtura të biodiversitetit apo zonave të dedikuara për kërkime shkencore.

4. Përshkrimi i Deponis të Karburanteve

4.1. Përshkrimi i pajimeve dhe objekteve ndërtimore

Kompleksi i depos (rezervarve) të karburanteve dhe ate për lëndë djegëse naftë dhe benzin të kompanisë "EURO ABI" në bazë të projektit të ndërtimit dhe konsultimeve me menaxherin e kompanisë "EURO ABI" përbëhet prej këtyre pajimeve dhe objekteve të cilat si tërsi nevojitën për realizimin e veprimtarive në depon e karburanteve dhe ate për lëndë djegëse të lëngta naftë dhe benzinë, si dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet e mundshme negative që shkaktohen nga depoja e karburanteve për lëndë djegëse naftë dhe benzinë.



Fig .7. Depoja e karburantit të lënget naftë e benzinë e Shpk"EURO ABI"

Në vijim po i shënojmë pajimet dhe objektet që jane dhe duhet të përbëjnë kompleksin e deponisë së karburanteve:

- Objekti i hyrjes
- Peshorja për autocisterna
- Stacioni i pompave për karburante të naftës dhe benzinës
- Stacioni i pompave për mbrojtje kundër zjarrit.
- Rezervarët e karburanteve për naftë dhe benzinë me muret mbrojtëse.
- Kolektori i zbrazjes së autocistrnave.
- Objekti për ngarkimin i auto-cisternave.
- Rezervari i ujit me kapacitet 100 000 litra
- Trafostacioni
- Gropa septike.
- Bunari filtrues.
- Platoja funksionale, rrugët dhe hapësirat për parkim të autocisternave dhe veturave.
- Vija hekurudhore, hapësira për vagona cisterna
- Grumbulluesit e ujit.
- Oazat gjelbëruese.
- Rrethoja e lokacionit.

4.2. Objekti i administratës,

Objekti i administratës me hapësirat tjera ka një arkitekture moderne, te thjeshte dhe funksionale, posedon hapësirë e cila përdoret për personelin dhe punëtorët që shërbejnë ne depon e karburanteve, zyrën për manipulim me peshoren, zyre për personelin. Ne objekt janë të vendosura pikat e sanitarise dhe Hidranti. Pikat e sanitarise duhet punuara sipas rregulloreve dhe standardeve te kohës.

4.3. Platoja e kompleksit

Platoja e kompleksit të depos (rezervarve) te karburanteve dhe ate për lëndë djegëse naftë dhe benzin të kompanisë "Euro Abi" duhet rregulluar ne mënyrë që ka pjerrtësinë e përshtatshme për grumbullimin dhe përcjelljen e ujërave sipërfaqësore , platoja ku bëhet shkarkimi i autocisternave, dhe cisternave vagona, ku bëhet ngarkimi i auto-cisternave është e betonuar me beton të armuar, kurse hapësirat tjera manipuluese rrugët dhe hapësirat për parkim janë të asfaltuara .

Organizimi për funksionimin e deponisë të karburanteve është i destinuar për hyrje në rrugën automobilistike dhe vijën hekurudhore e cila gjendet ne afersi te deponise (bazuar ne skicen e objekteve te deponis se karburanteve te naftes dhe benzines fig.7), hyrja dhe dalja e autocisternave dhe cisternave vagona në kompleksin e deponisë të karburanteve bëhet pa pengesë sepse hapësira për hyrje në kompleksin e deponisë të karburanteve dhe dalje është e mjaftueshme dhe dukshmëria është e mirë. Stacionet e pompimit të karburanteve janë objekt përdhes ne të cilat duhet te janë të vendosur pompat dhe pajisjet e tyre, janë prej konstruksionit metalik të rrethuara me panele termoizoluese .Peshorja është e ndërtuar ne hyrje të lokacionit me kapacitet 60t, komandohet nga hapësira e ndërtesës administrative. Kolektori për shkarkimin e karburanteve paraqet një gyp metalik ne të cilin bëhen kyçjet me gypa fleksibil prej autocisterneve dhe vendosur ne një kanal prej betoni të armuar të mbuluar prej pllakave lëvizëse të betonit.

4.4. Rezervarët e karburantit të naftës

Ne kompleksin e deponis së karburanteve dhe ate për deponimin e naftës dhe benzinës janë të vendosur kater rezervar mbi tokë me kapacitet si në vijim:

- Një (1) rezervar R1 për naftë me kapacitet prej Q=1,200 000 litra,

- Një (1) rezervar R2 për naftë me kapacitet prej Q=1,200 000 litra
- Një (1) rezervar R3 për benzin me kapacitet prej Q=1,200 000 litra
- Një (1) rezervar R4 për benzin me kapacitet prej Q=1,200 000 litra

Kapaciteti i përgjithshëm i rezervarëve për karburant të lëngët është Q=5,000 000 litra

Rezervarët janë cilindrik të ndërtuar prej çelikut sipas standardeve të caktuara për rezervarët për deponimin e naftës dhe benzinës dhe të vendosur kater rezervar mbi tokë në pozitë vertikale ne bazamentet te ndërtuar nga betoni.

Në të ardhmen kompania deshiron qe te vendos edhe kater rezervuar të tjere , dy rezervuar me derivate të naftes dhe dy të benzinës që në total do të jen tetë rezervuar me 10milion litra derivate të naftës dhe benzinës. Në Fig. 7 janë të paraqitura të gjihë rezervuaret dhe janë të evidentuara objektet percjellëse që e ndihmojn realizimin e ketij projekti, depon e rezervuareve të naftës dhe benzinës. Gjithashtu kompania në skice ka të shejuar edhe rrugën hekurudhore që e lidhe stacionin e pompave të ngarkimit dhe shkarkimit me hekuridhen kryesore të stacionit në Gerlicë, hekurudhë që ka shërbyer transportim te popullates dhe mallrave , Kosovë - Maqedoni dhe Kosove- Serbi.



Fig.8. Baza e situacionit të deponisë së derivateve të naftës dhe benzinës në Gerlicë
Skema e funksionimit të depos së derivateve të naftës dhe benzinës

Si që shihet në skeme , vetëm seksioni i parë është ende i pozicionuar edhe në ngastrat kadstrale të shpk ''Euro Abi'' për derisa seksioni pjesës lindore i rezervuareve R5,R6,R7,R8 do të vendosen ne te ardhmen (shih ,fig.9).



Fig. 9. Pamja ne ortofoto e rezervuareve të naftës dhe benzinës dhe infrastrukturen percjellese

Mbrojtja nga korrozioni do të bëhet për mes sistemit të katodës dhe me ngjyrë konform standardeve.

Mbushja dhe zbrazja e rezervarëve do bëhet nëpër mes sistemit të gypave special të cilët janë të vendosur në kanal prej betoni për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet eventuale.

Secili rezervar përmban dhe do të përmban pajisjet përcjellëse për funksionimin e tij:

- Shkallet e jashtme
- Shkallet e brendshme
- Kyçjen për mbushje dhe zbrazje
- Lëshuesin për dekantim ne formë konusi
- Pajisjet për matje të nivelit
- Pajisjet për ajrosje
- Kapakun për kontrollim ne kulm
- Kapakun për hyrje ne murin cilindrik
- Sistemin gypor për ftohjen e rezervarëve
- Gypin për zbrazje ne rast të tejngarkimit
- Rrufepritësin

4.5. Karakteristikat kryesore të procesit të aktiviteteve ne kompleksin e deponis së karburanteve

Procesi i aktiviteteve në kompleksin për deponimin karburanteve përfshin këto operacione të veprimit që janë të ndërlidhura në mes vedi.

- sistemi për zbrazje
- sistemi për deponimin e karburanteve
- sistemi për shpërndarjen e karburanteve

Sistemi për zbrazje të karburanteve dhe ate për lëndë djegëse naftë dhe benzinë do te bëhet nga autocisternat dhe cisternat ,vagonet për bartjen e karburanteve me anë të pompave centrifugale përmes mekanizmit të sistemit të gypave fleksibil të pajisur me instrumente matëse bëhet zbrazja në rezervuare. Sistemi i gypave dhe instrumenteve matëse kontrollohen para zbrazjes, në mënyrë që të eliminohen dukuritë e situatave aksidentale.

Matja e sasisë së deponuar në rezervuar matet drejtpërdrejt nga instrumentet matëse të vendosur ne autocisternë ose përmes peshojës elektronike të vendosur ne platon e

kompleksit të deponisë. Sistemi për deponim të karburanteve dhe ate për lëndë djegëse naftë dhe benzinë përbëhet, prej 4 rezervarve mbi tokë me kapacitet të përgjithshëm 5 000 000 litra.

Sistemi për shpërndarjen e karburanteve bahet njëjtë sikurse ne sistemin për zbrazje të karburanteve.Sistemi i funksionimit të pranimit dhe mbushjes se ketyre rezervuareve behet nga hekurudha nëpërmjet tre gypave ϕ-16cm dhe ϕ=10cm .



Fig.10 Pompa për ngarkimin ose shkarkimin e karburantit te derivateve (1)

Këtu, pompat janë të vendosura në hyrje të rrjetit të rezervuarëve, që sugjeron pozicion strategjik për kontrollin e fluksit hyrës dhe dalës të karburanteve

- Pozicioni i pompave në tokë, afër rrjetit të tubave dhe jo shumë afër rezervuarëve, sugjeron se ato kontrollojnë rrjedhjen në rrjetin dytësor ose primar.

- Mungesa e izolimit ose mbrojtjes ATEX tregon që ky sistem mund të jetë për naftë ose pjesë të jashtme të sistemit të benzinës (që zakonisht kërkon më shumë mbrojtje ndaj shpërthimit).

- Pajisja elektrike anësore (kutia e komandimit) është për kontrollin e pompave në mënyrë manuale ose automatike.



Fig.11 Rezervuari Naftes R1 dhe R2 , Shpk''EUROABI"



Fig.12. Rezervuari Benzines R3 dhe R4 , Shpk''EUROABI"



Fig.13. **Stacioni i shkarkimit dhe ngarkimit të derivateve**



a) b)

Fig.14 Sistemi matës volumetrik për naftë dhe benzinë

Përdoret për matjen dhe regjistrimin e sasisë së lëngjeve (kryesisht karburanteve ose produkteve kimike) të shpërndara nga depozitat drejt cisternave ose automjeteve transportuese.

Kjo pajisje është montuar në sistemin e ngarkim-shkarkimit të magazinimit te derivateve te lengeta naft dhe benzine me cisterna, mbi platformë metalike, me lidhje direkte në linjën e furnizimit të karburantit.

Funksioni

- Matja e rrjedhës volumetrike të lëngut në litra
- Kontrolli mekanik i shpërndarjes me valvul automatike
- Regjistrimi i sasisë së shpërndarë në kartela të posaçme
- Përdorimi i printerit të kartelës para dhe pas shpërndarjes sipas udhëzimeve



Fig.15 Peshorja dhe shtëpia për regjistrim të peshës së karburantit ,

Gypi i cili shërben për pranimin e naftës që vije dhe mbushjen e rezervuareve R1 ,R2, nga pompat thithëse të cilat janë të pozicionuara prapa rezrevuareve të lartëshenuara dhe përmes rezervuarit pranues nga 1200000 litra mbushen këto rezervuar R1 dhe R2, nga keto rezervuar permes pompave thithëse shërbehen kamionet me rezervuaret pranuese për dërgim deri në stacionet pranuese të kompanive që merren me shitje të këtyre derivateve.

Ndërsa për furnizim me benzin sherben gypi në të cilen mbushen rezervuari R3 dhe R4 , gjithashtu permes pompave thithëse, rezervuaret nuk janë duke punuar edhe pse jane funksional).

Rezervuaret e naftes R1 dhe R2 janë të rrethuar me mur të betonit dhe të izoluara ne dysheme ne ate menyre qe të ketë kapacitetin e mjaftueshëm te pranimit të naftës nëse do të ketë derdhje nga këto rezervuar R1 dhe R2, Fig.14. E njëjta gjendje është edhe me dy rezervuaret R3 dhe R4 , muret e ndertuara gjithashtu janë rezervuar rezerve në rast të derdhjes së benzinës jashtë rezervuarit R3 dhe R4, Fig15.



Fig.16 Rezervuari Naftes R1 dhe R2 , Shpk''EUROABI"



Fig.17 Rezervuari benzines R3 dhe R4 , Shpk''EUROABI"

Në tri vijat e gypave pranues të naftës dhe benzinës, duhet jenë kyqjet me ngjyre për pranim nga shkarkimet e naftës nga kamionet dhe gypi Gypi i cili sherben për pranimin e benzinës.





Fig.18 Vija ku jane të vendosur kokat e shkarkimit të naftes dhe benzines

Sistemi i ftohjes se ketyre rezervuareve do të behet përmes sistemit të hidrantit i cili nga rezervuari i ujit qe duhet të ketë kapacitetin mbajtes Q=100 000 litra (Fig7) . Ftohja bëhet permese hidranteve ne shpërndarjen e ujit ne pjesen e sipërme te rezervuareve ku uji ben ftohjet e jashtme te rezervuarit ne rrjedhëje deri ne dyshemet e ngastres ku janë te vendosura keta rezervuar. Uji qe bi ne dysheme orientohet permes kanalit akumulues dhe qarkullues deri ne impiantin e ujit i cili per mes gypit lidhe me pusetat e kanlizimit.

Gjithashtu duhet rregulluar sistemi i mbrojtjes nga zjarri ku duhet te jenë të vendosura në të gjitha këndët bombola përe fikjen e zjarrit.

I gjithe sistemi i vendosjes së objekteve të depos së rezervuareve dhe pjesëve integrale që sherbejn per funksianalizimin depos se karburanteve te lengeta duhet te u behet atesti.

4.6. Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve ne kompleksin e deponis së karburanteve

Komponentët hyrëse në procesin e aktiviteteve që zhvillohen në kompleksin e deponisë të karburanteve janë:

- Karburantet dhe ate për lëndë djegëse naftë dhe benzinë
- Energjia elektrike.
- Uji

Karburantet dhe ate si lëndë djegëse nafta dhe benzina shërbenë për furnizimin e automjeteve, për nevoja ne amvisni ne industri etj. Sasia e përgjithshme e karburanteve të lëngëta ne deponin e karburanteve është 5000 000 litra

Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike, nëpër mes trafostacionit që është pronë e kompanisë.

Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare ,për larjen e platosë së deponis të karburanteve dhe për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit.

Nevojat e ujit për sanitari varet nga numri i punëtorëve p.sh për një punëtor nevojiten 25 lit. ujë/ditë. Furnizimi me ujë në kompleksin e depos bëhet nga ujësjellësi i qytetit, uji i cili shfrytëzohet kryesisht për larje të pllatosë si dhe ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, dhe për mbushjen e rezervarit për mbajtjen e ujit rezervë (V=100 000 litra) për furnizim të pajisjeve kundër zjarrit do të bëhet nga pusi i cili është nxjerr me shpim të thellë.

4.7. Komponentët dalëse në procesin e aktiviteteve ne kompleksin e deponis së karburanteve

Komponentët dalëse nga procesi i aktiviteteve që zhvillohen në kompleksin për deponim të karburanteve janë :

- Karburantet dhe ate lëndë djegëse të lëngëta nafta dhe benzina
- Ujërat e ndotura.
- Avujt i hidrokarbureve dhe gazrat shkarkuese nga autocisternet.
- Zhurma.
- Mbeturinat e ngurta.

5. Përshkrimi i alternativave të projektit

Përshkrimi i alternativave të projektit paraqet pjesë të rëndësishme të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për deponinë e karburanteve të lëngëta – **naftë dhe benzinë**, të **SHPK "EURO ABI"**, në lokalitetin **Gerlicë – Komuna e Kaçanikut**. Analiza e alternativave bëhet me qëllim që të vlerësohen mundësitë e ndryshme të realizimit të projektit, ndikimet e tyre në mjedis dhe arsyetimi për zgjidhjen e përzgjedhur.

Në përputhje me kërkesat e **Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2025**, raporti i VNM-së duhet të trajtojë alternativat e mundshme të projektit, duke përfshirë alternativën "pa projekt", alternativën e lokacionit, alternativat teknike, mënyrën e menaxhimit të ndikimeve dhe arsyetimin pse është përzgjedhur varianti i propozuar.

Në rastin e deponisë së karburanteve, alternativat duhet të analizohen duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit, ndjeshmërinë e karburanteve që ruhen, rrezikun nga rrjedhjet, mbrojtjen e ujërave, kontrollin e avujve të benzinës, mbrojtjen nga zjarri, qarkullimin e autocisternave dhe përshtatshmërinë e lokacionit.

5.1. Alternativa e mos funksionimit te deponise se rezervuareve

Alternativa mosfunksionimin e deponisë së karburanteve në lokacionin e propozuar. Në këtë rast, lokacioni do të mbetej në gjendjen ekzistuese, me përdorim kryesisht si **tokë pyjore – mal, klasa III**, dhe me disa sipërfaqe rrugore private.

Nga aspekti mjedisor, alternativa e mos funksionimit te deponise se rezervuareve do të shmangte ndikimet që lidhen me:

- pranimin dhe shkarkimin e karburanteve;
- ruajtjen e naftës dhe benzinës;
- qarkullimin e autocisternave;
- avujt e benzinës;
- rrezikun nga rrjedhjet aksidentale;
- rrezikun nga zjarri dhe shpërthimi;
- krijimin e mbeturinave të kontaminuara;
- nevojën për menaxhim të ujërave të ndotura.

5.2. Alternativa e lokacionit të zgjedhur

Alternativa e lokacionit të zgjedhur përfshin zhvillimin e deponisë në **Gerlicë – Komuna e Kaçanikut**, në kuadër të **Zonës Kadastrale Begrac**, në sipërfaqen prej rreth **12,233 m²**. Ky lokacion është përzgjedhur për shkak të mundësisë së organizimit të një kompleksi të mbyllur dhe të kontrolluar për deponimin e karburanteve.

Lokacioni mundëson vendosjen e elementeve kryesore teknike të deponisë, si:

- objekti i hyrjes;

- peshorja për autocisterna;
- rezervuarët e naftës dhe benzinës;
- muret mbrojtëse rreth rezervuarëve;
- stacioni i pompave për karburante;
- stacioni i pompave kundër zjarrit;
- rezervari i ujit prej 100,000 litra;
- kolektori i zbrazjes së autocisternave;
- objekti për ngarkimin e autocisternave;
- trafostacioni;
- sistemi i grumbullimit të ujërave;
- separatori i vajrave dhe hidrokarbureve;
- rrugët e brendshme dhe platot funksionale;
- oazat gjelbëruese;
- rrethoja e lokacionit.

Nga aspekti mjedisor, lokacioni kërkon masa të plota mbrojtëse, sepse një pjesë e madhe e ngastrave evidentohet si tokë pyjore. Për këtë arsye, aktiviteti duhet të kufizohet brenda zonës së projektit dhe nuk duhet të shkaktojë dëmtim të panevojshëm të tokës, vegjetacionit dhe peizazhit përreth.

Përparësitë e lokacionit të zgjedhur janë:

Përparësia	**Përshkrimi**
Mundësi organizimi të kompleksit të mbyllur	Lokacioni mund të rrethohet dhe kontrollohet
Sipërfaqe e mjaftueshme për objektet teknike	Mundëson vendosjen e rezervuarëve, pompave, rrugëve dhe platove
Mundësi për qarkullim të autocisternave	Mund të organizohen hyrje, peshim, ngarkim-shkarkim dhe dalje
Mundësi për sistem kundër zjarrit	Parashihet rezervar uji 100,000 litra dhe stacion pompash
Mundësi për menaxhim të ujërave	Mund të vendosen grumbulluesit dhe separatori i vajrave
Mundësi për gjelbërim mbrojtës	Oazat gjelbëruese mund të zvogëlojnë ndikimin vizual

.

Me zbatimin e masave të parapara teknike dhe mjedisore, lokacioni i zgjedhur mund të konsiderohet i pranueshëm për zhvillimin e aktivitetit.

5.3. Alternativa teknike e rezervuarëve dhe sistemeve mbrojtëse

Një ndër alternativat më të rëndësishme në këtë projekt lidhet me zgjidhjet teknike për rezervuarët dhe sistemet mbrojtëse. Për deponimin e naftës dhe benzinës mund të përdoren rezervuarë horizontalë ose vertikalë, një-mbështjellës ose dy-mbështjellës, të vendosur mbi bazamente të izoluara dhe brenda mureve mbrojtëse.

Nga aspekti mjedisor, alternativat më të sigurta janë ato që sigurojnë mbrojtje të dyfishtë ndaj rrjedhjeve. Për këtë arsye, rezervuarët dy-mbështjellës ose rezervuarët një-mbështjellës të vendosur brenda mureve mbrojtëse me dysheme të papërshkueshme konsiderohen zgjidhje më të përshtatshme.

Alternativa teknike	**Përparësitë**	**Kufizimet**
Rezervuarë një-mbështjellës me mure mbrojtëse	Zgjidhje e përdorshme nëse ka mbrojtje sekondare të plotë	Kërkon kontroll të rregullt dhe mur mbrojtës funksional
Rezervuarë dy-mbështjellës	Siguri më e lartë ndaj rrjedhjeve	Kosto më e lartë investive
Rezervuarë horizontalë	Qasje më e lehtë për mirëmbajtje	Mund të zënë më shumë hapësirë
Rezervuarë vertikalë	Shfrytëzim më racional i hapësirës për kapacitete më të mëdha	Kërkojnë bazament më të kujdesshëm
Bazamente të izoluara me beton	Mbrojtje e tokës dhe ujërave	Kërkojnë mirëmbajtje të çarjeve dhe nyjeve
Sistem me separator hidrokarburesh	Trajtim i ujërave të ndotura	Kërkon pastrim periodik dhe operator të licencuar

Për projektin konkret, alternativa më e pranueshme është përdorimi i rezervuarëve metalikë të certifikuar, të vendosur mbi bazamente të izoluara, me mure mbrojtëse, sistem të kontrollit të nivelit, tokëzim, ventilim të sigurt dhe lidhje me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura.

5.4. Alternativa e menaxhimit të ujërave të ndotura

Për deponinë e karburanteve, menaxhimi i ujërave është një nga çështjet më të rëndësishme mjedisore. Ujërat nga zonat operative mund të ndoten me hidrokarbure, prandaj duhet të grumbullohen dhe trajtohen para çdo shkarkimi eventual.

Në këtë projekt mund të konsiderohen disa alternativa:

Alternativa	**Vlerësimi mjedisor**
Shkarkim i drejtpërdrejtë i ujërave atmosferike	Nuk është i pranueshëm për zonat operative, sepse mund të bartë hidrokarbure

Alternativa	Vlerësimi mjedisor
Grumbullim pa trajtim	Nuk është i mjaftueshëm dhe paraqet rrezik për tokën e ujërat
Grumbullim dhe trajtim përmes separatorit	Alternativa më e pranueshme për ujërat nga platot dhe zonat teknologjike
Ndarje e ujërave të pastra nga ato të ndotura	Zgjidhje e domosdoshme për menaxhim efikas
Mbyllje emergjente e drenazhimit në rast derdhjeje	Masë shumë e rëndësishme për parandalimin e ndotjes aksidentale

Alternativa e përzgjedhur duhet të jetë ndarja e ujërave të pastra nga ujërat potencialisht të ndotura, grumbullimi i ujërave nga zonat operative dhe trajtimi i tyre përmes separatorit të vajrave dhe hidrokarbureve. Ujërat sanitare duhet të trajtohen veçmas, përmes gropës septike dhe bunarit filtrues, nëse nuk ka lidhje me kanalizim publik.

5.5. Alternativa e mbrojtjes nga zjarri dhe aksidentet

Për shkak të pranisë së naftës dhe benzinës, mbrojtja nga zjarri është kriter themelor në zgjedhjen e alternativës teknike. Alternativa më e pranueshme është ajo që siguron sistem të plotë të mbrojtjes nga zjarri, përfshirë rezervën e ujit, pompat kundër zjarrit, hidrantët, aparatet portative, tokëzimin, sinjalistikën dhe planin emergjent.

Alternativa pa sistem të plotë kundër zjarrit nuk është e pranueshme për këtë lloj aktiviteti.

5.6. Arsyetimi profesional për alternativën e përzgjedhur

Duke marrë parasysh natyrën e projektit, lokacionin, sipërfaqen, karakterin e tokës dhe rreziqet që lidhen me naftën dhe benzinën, alternativa më e pranueshme është zhvillimi i projektit në lokacionin e propozuar, por vetëm me zbatimin e plotë të masave teknike dhe mjedisore.

Alternativa e përzgjedhur duhet të përfshijë:

- rezervuarë metalikë të certifikuar për naftë dhe benzinë;
- bazamente të betonizuara dhe të izoluara;
- mure mbrojtëse rreth rezervuarëve;
- sistem të mbyllur të mbushjes dhe shkarkimit;
- kontroll të avujve të benzinës;
- tokëzim të rezervuarëve, tubacioneve, pompave dhe autocisternave;
- platforma të papërshkueshme për ngarkim-shkarkim;
- sistem të ndarë për ujërat e pastra dhe ujërat potencialisht të ndotura;

- separator të vajrave dhe hidrokarbureve;
- rezervar uji prej 100,000 litra për mbrojtje nga zjarri;
- stacion pompash kundër zjarrit;
- rrethim të lokacionit dhe kontroll të qasjes;
- oaza gjelbëruese dhe mirëmbajtje të peizazhit;
- plan emergjent dhe trajnim të personelit.

Në përfundim, alternativa e propozuar konsiderohet e pranueshme nga aspekti mjedisor vetëm nëse projekti realizohet dhe operon me sistem të plotë mbrojtës. Alternativa **mos funksionimit te deponise se rezervuareve** shmang ndikimet, por nuk realizon qëllimin ekonomik dhe funksional të investitorit. Alternativa e lokacionit të zgjedhur, me masa të plota teknike, ofron mundësi për zhvillim të aktivitetit duke mbajtur ndikimet në nivel të kontrollueshëm dhe të pranueshëm mjedisor.

6. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasoj e proceseve (veprimeve) që kryhen të depon e karburanteve dhe ate lëndë djegëse naftë dhe benzinë tregojnë se deri te kvantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kavantifikimi i tyre . Gjatë punës kontinuele të depos së karburanteve vie deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga qarkullimi i autocisterneve dhe cisternave vagona, derdhjet dhe avullimi i karburanteve, krijohet zhurmë nga motorët e autocisterneve dhe cisternat vagona dhe funksionimi i automatëve për dhënie të karburanteve, në mënyrë indirekte mund të vie deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër kompleksit të deponisë së karburanteve .

Entitetet e cenueshme që potencialisht rrezikohen janë të punësuarit në depon dhe shfrytëzuesit e shërbimeve - shoferët e autocisterneve .

6.1. Ndotja e ajrit

Ndikimet në ajër nga deponia e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë, të SHPK "EURO ABI", në lokacionin Gerlicë – Komuna e Kaçanikut, lidhen kryesisht me avullimin

e hidrokarbureve, aromat karakteristike të karburanteve, emetimet nga autocisternat dhe pluhurin që mund të krijohet nga qarkullimi i mjeteve. Ndikimi më i rëndësishëm në ajër paraqitet nga benzina, për shkak të avullueshmërisë së saj më të lartë dhe mundësisë së krijimit të avujve të ndezshëm.

Në kushte normale të operimit, ndikimet në ajër pritet të jenë lokale, periodike dhe të kontrollueshme, me kusht që të funksionojnë sistemi i mbyllur i mbushjes dhe shkarkimit, ventilimi i rezervuarëve, tokëzimi, kontrolli i valvulave dhe mirëmbajtja periodike e pajisjeve.

Gjatë funksionimit kontinuel të depos së karburantëve nga qarkullimet e autocisterneve dhe automjeteve vie deri te rritja e ndotjes së ajrit nga emisioni i gazrave nga autotocisternet dhe nga avullimi i karburantit benzinë. Gazrat nga djegëjet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NOx, HxCy, SO2 dhe Pb.
Ndikimi i tyre në shkallën e ndotjes varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe dendësisë së qarkullimit të komunikacionit në lokacionin e kompleksit për deponim të karburanteve, numri i autocisterneve që nevojitet për bartjen e karburantit naftë dhe benzinë gjer te deponia si dhe nga deponia, krahasuar me automjetet që qarkullojn në rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj është i pa përfillshem.
Duke i marruar parasysh përqendrimet e ndotësve përgjatë rrugës dhe përqendrimet te cilat emitohen ne vetë kompleksin për deponim të karburanteve , mund të përfundohet se ndikimi i kompleksit për deponim të karburanteve në ndotjen e ajrit ne lokacionin e kompleksit të deponis së karburanteve dhe rrethinës së tij është me përmasa relativisht nën përqendrimet e lejuara.

6.2. Ndotja e ujit

Ndikimet në ujë nga deponia e karburanteve të lëngëta – naftë dhe benzinë, të SHPK "EURO ABI", në lokacionin Gerlicë – Komuna e Kaçanikut, përfaqësojnë një nga çështjet më të rëndësishme të vlerësimit mjedisor. Kjo lidhet me faktin se nafta, benzina, vajrat dhe

hidrokarburet tjera, në rast rrjedhjeje ose menaxhimi jo të rregullt, mund të ndotin ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore dhe sistemet lokale të drenazhimit.

Në kushte normale operimi, ndikimi në ujë mund të mbahet në nivel të kontrollueshëm, nëse funksionojnë si duhet: bazamentet e izoluara, muret mbrojtëse të rezervuarëve, platformat e papërshkueshme, sistemi i grumbullimit të ujërave atmosferike, separatori i vajrave dhe hidrokarbureve, gropa septike dhe procedurat e reagimit në rast derdhjeje.

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore është nëse vie deri te shpërthimet e rezervarëve me karburant naftë dhe benzinë të vendosur mbi tokë. Mundësia e derdhjes së derivateve gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë shpërndarjes së derivateve, nga sistemi i pompave dhe nga sipërfaqet ku është i vendosur gjeneratori.
Pastaj gjatë funksionimit kontinuel të kompleksit për deponim të karburanteve në sipërfaqet shërbyese për komunikacion vie deri te sedimentimi i materieve ndotëse që është si rezultat i fundërrimit nga gazrat e liruar nga djegja e lëndëve djegse motorike, i fshirjes së gomave të automjetit ,i rrjedhjes së derivateve dhe vajrave nga cisternet vagon, autocisternat dhe automjetet , i fundrrimeve nga atmosfera etj.
Vlerat më të larta të ndotjes së ujërave nga sipërfaqet shërbyese të kompleksit për deponim të karburantit naftë pritet të jenë gjatë zezonave të dimrit kur kemi hedhjen e kripës nëpër platon e deponisë dhe rrugët rrethë deponisë.
Ndotje e mjedisit ndodh nga pluhuri i cili lirohet dhe emitohet gjatë procesit të zbrazjes dhe ngarkimit koksit në deponin për deponimin e koksit.
Koncentracionet e ndotësve të sedimentuar në platon e kompleksit për deponim të karburantit drejtpërdrejt varet nga zgjatja e periodave të thata dhe pa shi dhe nga dendësia e qarkullimit të autocisterneve dhe cistrnave vagon. Koncentracioni i grimcave të suspenduara është proporcional me sasinë e ujërave nga shpërlarja apo nga të reshurat atmosferike ku koncentracionet më të mëdha janë në 5- 10 min. e para të shpërlarjes së sipërfaqes së platosë nga personeli apo nga të reshurat atmosferike .

6.3. Ndotja e tokës

Toka (dheu) si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vie deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të

saja. Në aspektin e ndotjes së dheut dallojmë dy faza edhe atë periodën gjatë ndërtimit dhe periodën e shfrytëzimit, veprimeve kontinuale ne kompleksin për deponim të karburantit naftë dhe benzinë.

Në fazën e shfrytëzimit të deponis të karburantit naftë dhe benzinë ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellën përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqja e platosë së deponis të karburantit naftë dhe benzinë dhe nga fundërrimet e komponentëve ndotëse nga ajri, kjo ndotje njihet si ndotje sistematike e dheut gjatë funksionimit kontinuel të deponisë të karburanteve të naftës dhe benzinës pastaj kemi edhe ndotjen aksidentale të dheut e cila vie si pasoj e avarive të mëdha apo të vogla të pajisjeve. Këto ndotje të dheut evitohen vetëm me largimin e dheut të kontaminuar dhe transportimin e tij në vendet e caktuara aty ku nuk rrezikojnë mjedisin. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) afër deponis të karburanteve të naftës dhe benzinës varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqja e platosë së deponisë të karburanteve naftë dhe benzinë , konfiguracioni i terenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethin e deponisë të karburanteve naftë dhe benzinë.

6.4. Zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit , në sistemin nervor , në hipertension , në koncentrim e njeriut në punë etj.

Lokacioni i deponis së karburanteve të naftës me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së autocisterneve dhe automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugën magjistrale Kaqanik - Ferizaj që është ne afërsi të lokacionit, zhurmës së autocisterneve, nga funksionimi i pompave dhe kompresorëve për zbrazjen dhe shpërndarjen e karburanteve dhe në mungesë të energjisë elektrike kyçja e shpeshtë e agregatit për energji elektrike.

Mundë të konstatojmë se në lokacionin ku është ndërtuar depoja (rezervarët) e karburanteve dhe ate për lëndë djegëse të lëngta naftë dhe benzinë të kompanisë „Euro Abi", nuk kemi ndonjë zhurmë të përhershme përpos zhurmës së autocisterneve, cisternave vagon dhe automjeteve, që do të ndikonte në psiqikën dhe koncentrimin e njeriut në punë dhe rrethinë . Sipas gjendjes faktike të kompleksit për deponim të karburanteve në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB është nën vlerën e lejuar prej 60 dB .

6.5. Ndikimet në florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri më tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vie deri te ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar ku është i ndërtuar kompleksi për deponimin e karburanteve naftë dhe benzinë nuk do të kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe nën platonë e kompleksit të deponis së karburanteve kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të polutantëve .

E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet që kompleksi për deponimin e karburanteve të naftës dhe benzinës të ketë ndikime negative ne faunën.

7. Vlerësimi i Rrezikimit të Mjedisit nga Aksidentet e Mundëshme

Me që kemi të bëjmë me kompleksin e depos ku kemi deponimin dhe distribuimin e karburanteve dhe ate lëndë djegëse të lëngët naftë dhe benzinë nga edhe buron rrezikimi i mjedisit gjatë rasteve aksidentale .

Në rastet e jashtëzakonshme, gjatë derdhjes jo të kontrolluara të karburanteve dhe ate lëndë djegëse të lëngëta naftë dhe benzinë mundë të vie deri te aksidentet kimike, intensiteti aksidental i të cilëve mundë të jetë i shkallëve të ndryshme.

Nga manipulimet e ndryshme vepruese me karburantet naftë dhe benzinë, në kompleksin për deponimin e karburanteve dhe ate lëndë djegëse të lëngëta naftë dhe benzinë mundë të vie deri te rrjedhja apo derdhja e sasive të karburanteve të naftës dhe benzinës ku nga avullimi i tyre sjell deri te ndotja e ajrit në hapësirën e deponis dhe hapësirën për rreth tij.

Në aspektin teorik aksidentet e një shkalle më të lartë në kompleksin për deponimin e karburanteve të naftës dhe benzinës mundë ndodhin në rezervuarët me karburante të naftës dhe benzinë të vendosur mbi tokë e sidomos gjatë mundësis së derdhjes (rrjedhjet) si dhe nga auto cisternat dhe cisternat vagon.

Të gjitha situatat aksidentale gjatë deponimit dhe distribuimit me derivate dhe ate lëndë djegëse të lëngëta naftë dhe benzinë mundë të i kategorizojmë në katër grupe :

- Explodimi i avullit të karburanteve që janë në gjendje vlimi
- Explodimi i gazrave të reve të pakufizuara
- Explodimet e kufizuara
- Zjarri

Aksidentin e parë duhet përjashtuar nga analiza sepse për të ardhur deri te ky aksident karburanti në rezervuar duhet të jetë mbi temperaturën e vlimit.

Aksidenti i dytë mundë të shkaktohet gjatë manipulimit me naftë dhe benzinë në deponin e karburanteve të naftës dhe benzinës ku mund të vie deri te përzierja e avullit të karburanteve me ajrin dhe të krijojnë një përzierje potenciale e cila gjatë koncentracioneve të caktuara dhe energjisë së mjaftuar për aktivizim mundë të shkaktojë detonacion explodues me pasoja të mëdha.

Mundësia e një aksidenti të tillë është shumë e vogël kur kemi parasysh lokacionin e objektit, llojin dhe sasinë e derivateve, dendësin e autocisterneve dhe cisternave vagon të cilat furnizojn deponin me naftë dhe benzin , shpejtësinë e avullimit të karburanteve etj.

Sa i përket zjarrit mundë të konstatojmë se realisht është e mundur por nuk do të bëjmë ndonjë analizë detale mbi vlerësimin e rrezikut nga zjarri kur kemi parasysh faktin se ekziston projekti kundra zjarrit dhe mbrojtja nga zjarri si dhe të gjitha masat preventive që duhet të ndermirën gjatë një aksidenti nga zjarri.

Në rastet e aksidentit nga zjarri në lokacionin dhe rrethinën e deponis të karburanteve të naftës dhe benzinës mundë të rrezikohet jeta dhe shëndeti i njeriut si dhe mjedisi rrethues, kur kemi parasysh toksitetin e produkteve të djegëjes (monoksidi i karbonit dhe formaldehidet), masën e gaztë të produkteve të djegëjes ,shkallën e nxehtësisë , produktet jo plotësisht të djegura të derivateve naftë dhe benzinë etj.

Në kuptim më të gjerë , rast aksidental në aspektin e mbrojtjes së mjedisit gjatë manipulimit me derivate të naftës dhe benzinës në deponin e karburantit naftë dhe benzinë është derdhja e karburantit naftë dhe benzinë deri në at sasi që rrezikon mjedisin, prandaj është e nevojshme që të bëhet sanimi i ndotjes sipas metodave adekuate.

Nëse rregullorja e punës së një kompleksi të deponis për deponim të karburantit naftë dhe benzinë përmban në detale të gjitha aktivitetet dhe veprimet për sanimin e aksidentit nga derdhjet e derivateve, mund të konstatojmë se derdhjet e karburantit naftë dhe benzinë nuk mundë të rrezikojnë mjedisin.

7.1. Vlerësimi i pasojave të mundshme

Pasojat e mundshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisin parashtrohen ne bazë të dhënave të përfituara me analizën e cenueshmërisë.

Me anë të analizës se cenueshmërisë evidentohen të gjitha entitetet dhe objektet e cenueshme ne rrethinën e burimit potencial të aksidentit:

- të punësuarit në kompleks
- pjesëmarrësit në rrethinë
- objektet afariste dhe të banimit

Rrezikshmëria nga karburantet dhe ate lëndë djegëse naftë dhe benzinë është evidente nëse gjatë punës nuk i kushtohet kujdes dhe ato rrjedhin ne mjedis. Nëse merren të gjitha masat paraprake për pengimin e rrjedhjeve të karburanteve dhe ate lëndëve djegëse naftë dhe benzinë duke zbatuar normat e kualitetit gjatë ndërtimit si dhe montimin e instalimeve më kualitative dhe sipas standardeve për ndërtimin e depos të karburantit dhe ate lëndë djegëse të lëngëta naftë dhe benzinë gjasat për të ndodhur ndonjë ndotje eventuale janë të vogla.

8. Masat e Mbrojtjes së Mjedisit

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e kompleksit të deponis për deponimin e karburanteve dhe ate lëndë djegëse të lëngët naftë dhe benzinë në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit të kompleksit së deponisë i cili është punuar sipas projektit të ndërtimit, kompleksi i deponisë për deponimin e karburanteve dhe ate lëndë djegëse të lëngta naftë dhe benzinë të kompanisë „Euro Abi" me veprimtarinë kontinuale të sajë në lokacionin e analizuar nuk rrezikon mjedisin sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vie deri te ndotja duhet të ndermirën masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor .

Me qëllim të zvogëlimit të mëtejmë të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave shtesë të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në kompleksin për deponimin e karburanteve të naftës dhe benzinës në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

8.1. Masat mbrojtëse të ujërave

Edhe pse kompleksi për deponimin e karburanteve dhe ate lëndë djegëse naftë dhe benzinë të kompanisë „ Euro Abi" nuk gjeneron ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, por ndotja ndodhe si që e kemi përshkruar ne pasuset e mësipërme. Ne kompleksin e deponisë për deponimin e karburanteve dhe ate lëndë djegëse

të lëngta naftë dhe benzinë do të rregullohet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura nga sipërfaqet manipulative.

Pasi që në kompleksin e deponisë për deponimin e karburanteve sipas projektit të ndërtimit është ndërtuar separatori për vajra, dhe gropa septike.

Nëse separatori i ndërtuar nuk i plotson kushtet për trajtimin e ujrave të ndotura, duhet të ndërtohet seperatori sipas standardeve dhe ne bazë të përmasave dhe përshkrimit që janë dhën ne projektin kryesor të ndërtimit të deponis së karburanteve për ndërtimin e seperatorit të vajrave.

Seperatori i vajrave për mes mureve ne disnivele e bën ndarjen (seperimin) e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura dhe i deponon ne pusetën e posaçme, ku pas mbushjes së pusetës duhet të pastrohet nga ndërmarrjet e licencuara për pastrimin e seperatorve dhe gropave septike. Seperatori duhet të përmbush kriteret teknike që janë te parapara me rregullore dhe normative ne fuqi. Seperatori duhet të rregullohet në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet (trajtohet) dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet. Ujërat e trajtuara ne seperator dhe gropën septike dërgohen ne bunarin filtrues që duhet të ndërtohet ne bazë të përmasave që do të shënohen ne projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit të deponisë së derivateve.

Shemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura e paraqesim në vijim.



Ne shemën ne vijim është paraqitur gropa septike me puesetat kontrolluese dhe pusin filtrues.



Ujërat nga separatori dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë derivate të naftës mbi 1mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30mg/l në ujë.

Pronari i kompanisë „Euro Abi" , duhet të e bëj matjen e cilësisë të ujit të shkarkuar nga seperatori i vajrave , vlerat e fituara do të krahasohen dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit administrativ nr. 13/2008, për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet ne trup ujorë dhe ne rrjetin e kanalizimit publik.

8.2. Masat për mbrojtjen e tokës

